



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:070545

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05414592

C.nr.428/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Sh.I nga komuna e Vushtrri dhe B.M nga komuna Vushtrri, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.V.K nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensim të shpenzimeve të udhëtimit për ditët e pranisë në punë, jashtë seance, me datën 05.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
(pa shqyrtim gjyqësor)

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve Sh.I nga komuna Vushtrri dhe B.M nga komuna Vushtrrisë, me të cilën kanë kërkuar kompensim e shpenzimeve të udhëtimit, ashtu qe DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që:

a) Paditësit Sh.I nga komuna Vushtrri në emër të kompensimit të shpenzimeve për udhëtim (në shkallë prej 70% të lartësisë se biletës për 881 ditë udhëtimi ) për periudhën kohore nga data 16.04.2018 e gjere me datën 21.11.2022, shumën prej 616,70 euro, si dhe

b) Paditëses B.M nga komuna e Vushtrrisë, në emër të kompensimit të shpenzimeve për udhëtimit (në shkallë prej 70% të lartësisë se biletës për 881 ditë udhëtimi) për periudhën kohore prej datës 16.04.2018 e gjere me datën 21.11.2022, shumën prej 1233,40 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë me datën 16.04.2021 e gjerë në pagesën definitive të detyrimeve si dhe shpenzimet e procedure kontestimore në lartësi të përgjithshme prej 177.00 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, këtë kërcënim të përmbarimit me detyrim.

III.Konstatohet e terhequr padia dhe kërkesëpadia e paditësve E.K dhe S.K me të cilën kanë kërkuar kompensim e shpenzimeve të udhëtimit kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim.

II.REFUZOHET pjesërisht pjesërisht e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve Sh.I nga komuna Vushtrri dhe B.M nga komuna Vushtrrisë, me të cilën kanë kërkuar kompensim e shpenzimeve të udhëtimit dhe atë paditësit Sh.I në lartësi prej 2,30 euro, ndërsa paditëses B.M në lartësi prej 5,60 euro.

**A r s y e t i m**

Paditësit Sh.I nga komuna e Vushtrrisë dhe B.M nga komuna e Vushtrrisë, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi me datë 16.04.2021, me të cilën kanë kërkuar që të obligohet e paditura që

për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, t'ua kompensoje shpenzimet e udhëtimit, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e gjerë në pagesën definitive si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilim të padisë shumen prej 156.00 euro si dhe për takse gjyqësore 21 euro.

Përfaqësuesi i paditësve me parashtrësen e datës 06.11.2023 është terheqë nga padia e paditësve E.K dhe S.K.

Gjykata me aktvendimin C.nr.428/21 të datës 17.10.2023, ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 22.11.2023.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadija e paditësve është parashkruar pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 18.04.2017 ndërsa paditësit e kanë paraqitur padinë në gjykatë me datë 16.04.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit është me efekt veprimi deri më 18.04.2020 dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësve ta hedhë poshtë si të pajuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palës nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqës të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe nga vërtetimi i lëshuar nga Gjimmnazi "E..." në Vushtrri, i datës 30.10.2023 për Sh.I si dhe për paditësen B.M nga vërtetimi i lëshuar nga Gjimmnazi "E..." e datës 27.10.2023 Vushtrri kontestuese nuk ishte prania e paditësëve në punë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve për udhëtim.

Kontestuese ishte parashkrimi i kërkesës së paditësve.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *"kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë"*, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *"kreditoret në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitorit ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij"*, e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *"Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore"*, si dhe vërtetimeve të lëshuara për paditësit, gjeti se paditësi Sh.I, gjatë periudhës 16.04.2018 e deri më 21.11.2022, ka vijuar punën për 881 ditë në Gjimmnazi "E..." në Vushtrri dhe për të vijuar punën ka udhëtuar në relacionin D...-Vushtrri dhe anasjelltas dhe ka paguar çmimin e biletës në një drejtim 0.50 euro, që d.m.th. për një ditë punë ka shpenzuar prej 1.00 euro, fakte këto të vërtetuara nëpërmjet vërtetimit të datës 30.10.2023, i lëshuar nga Gjimmnazi "E..." në Vushtrri, po ashtu edhe nga vërtetimi i ndërmarrjes shërbyese transportuese "N...", për paditësen B.M, gjykata gjeti se njëjti gjatë periudhës 16.04.2018 e deri më

21.11.2022, ka vijuar punën për 881 ditë në Gjimnazi "E..." në Vushtrri dhe për të vijuar punën ka udhëtuar në relacionin M...-Vushtrri dhe anasjelltas, dhe ka paguar çmimin e rrugës për një drejtim 1 euro, që d.m.th. në ditë ka shpenzuar shumë prej 2 euro, fakte këto të vërtetuara nëpërmjet vërtetimit të datës 27.10.2023, i lëshuar nga Gjimnazi "E..." në Vushtrri, përkatësisht vërtetimi i ndërmarrjes shërbyese transportuese "T..."

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, gjykata e vlerësoj si të pa bazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se "*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*", ndërsa paditësit kërkesën e tyre e kanë parashtruar për periudhën nga data 16.04.2018 deri më 21.11.2022, që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2021, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë më 16.04.2021.

Gjithashtu vlen të theksohet se Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 në nenin 45 të saj ka paraparë se Kontrata Kolektive do të zbatohet edhe për një vit tjetër nëse palët nuk tërhiqen nga e njëjta ndërsa gjykata nuk ka prova se nga e njëjta janë terheqë ndonjë palë kontraktuese.

Gjykata vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 261 par 1 të LPK-së pasi që paditësit janë terheqë nga padia dhe kërkesëpadia tyre.

Gjykata vendosi si në pikën III të këtij aktgjykimi që paditëseve Sh.I nga komuna Vushtrri dhe B.M nga komuna Vushtrrisë, pjesërisht të ua refuzoj kërkesëpadinë e tyre duke pasur parasysh se në bazë të vërtetimave të dorëzuar për tërësinë e ditëve të punës për periudhën kohore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, që të dy paditësit kanë pasur vetëm nga 881 ditë të praniës në punë.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditëseve ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartës prej 8%, duke llogaritur nga data 16.04.2021, dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shpenzimet e procedurës, bazuar në nenin 452 të LPK-së, duke ia njohur paditëses shumë prej 177 euro, shpenzime këto të cilat iu referohen shpenzimeve për pagesën e taksës për padi në shumë prej 21,00 euro, si dhe për përpilimin e padisë shumë prej 156.00 euro ndërsa nuk ia njohu shumë prej 156 euro për precizim të kërkesëpadisë pasi që pala ka pasur për detyrë ta precizoj kërkesën e saj fillimisht me paraqitjen e padisë pranë kësaj gjykate.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil  
C.nr.428/21, datë: 05.03.2024

Gj y q t a r i  
Izet Gërguri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.

Numri i lëndës: 2021:070545  
Datë: 05.03.2024  
Numri i dokumentit: 05414592